

VENDIM ASAMBLEJE Nr. 5
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "MAK ALBANIA" sh.p.k

Sot ne date 15 Nentor 2018, u mblodh Asambleja e Ortakut te vetem te Shoqerise "MAK ALBANIA" sh.p.k ("Shoqeria"), me seli ne adresen: Njesia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/58, Zona Kadastrale 8160 Tirane, Shqiperi, regjistruar prane QKB-se me NIPT J61821059A, e perbere nga:

- **Ortaku i vetem, shoqeria "KASTRATI"sh.a**, zoterues i 1 (nje) kuote qe perben 100% te kapitalit te Shoqerise, e perfaqesuar nga ortaku i vetem i saj Z. Shefqet KASTRATI, i biri i Jonuzit, lindur ne Brrut, Kukes, i datelindjes 05.06.1961, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me ane te Pasportes me numer Nr. SJ0883679.

Asambleja eshte thirrur rregullisht ne perputhje me kerkesat ligjore dhe te statutit te saj. Ne mbledhje perfaqesohen teresisht pjeset e kapitalit themeltar, dhe asambleja eshte e afte te marre vendime te vlefshme lidhur me rendin e dites si me poshte vijon:

1. Zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;
2. Modalitetet e zvogelimit te kapitalit;
3. Aprovimin e raportit te ekspertit kontabel te regjistruar **Mbi «Pasqyrat financiare per qëllim te transferimit te aktivitetit të shoqërisë»;**
4. Ndryshimi i statutit te shoqerise;
5. Autorizimin per kryerjen e formaliteteve te publikimit;
6. Te ndryshme dhe te mundshme.

Pas diskutimit te ceshtjeve sipas rendit të ditës Asambleja e Ortakut te Vetem miraton vendimet e meposhtme:

I. Vendimi I Pare


Ortaku I vetem miraton zvogelimin e kapitalit te shoqerise "MAK ALBANIA" sh.p.k nepermjet Marreveshjes se Transferimit nr.3220 rep, nr.1510 kol, date 09.11.2018, te nje pjese te prones me numer pasurie nr.7/58 dhe te aktivitetit te shoqerise , qe korrespondon ne masen prej 668,266,764 (Gjashteqind e gjashtedhjete e tetemilion e dyqind e gjashtedhjete e gjashtemije e shtateqind e gjashtedhjete e kater) Leke, kapital I cili nepermjet marreveshjes se sipercituar do te transferohet tek Shoqeria "KASTRATI HOTELS & TOWER" sh.p.k.

II. Vendimi I Dyte

Zvogelimi I kapitalit do te kryhet nepermjet uljes se vleres nominale te kuotes ne masen 668,266,764 leke. Pas zvogelimit te kapitalit shuma e kapitalit themeltar te shoqerise do te jete 11,238,757,236 Leke e perbere nga nje kuote me vlere nominale 11,238,757,236 Leke.

III. Vendimi i trete

Miratimin e Raportit të Ekspertit Kontabel te Shoqerise "MAZARS" sh.p.k " **Mbi «Pasqyrat financiare per qëllim te transferimit te aktivitetit të shoqërisë» Mak-Albania sh.p.k.**



IV. Vendimi i Katert

Asambleja e Ortakeve vendos te miratoje modifikimet te neneve vijuese te statutit:


Neni 5, paragrafi 1 i statutit te shoqerise ndryshohet si vijon” Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 11,238,757,236 leke e perbere nga nje kuote e cila zoterohet 100% nga shoqeria “KASTRATI” sh.a.

V. Vendimi i Peste

Asambleja e Aksionereve autorizon Administratorin e Shoqerise Z. Elsi KECO dhe ne mungese te tij cdo person te trete te autorizuar prej tij, te ndjeke te gjitha procedurat legale te kerkuara nga legjislacioni shqiptar per realizimin e operacionit te zvogelimit te kapitalit themeltar te shoqerise.

Meqenese asambleja nuk ka ceshtje te tjera per te diskutuar, mbledhja mbyllet. Per sa u diskutua ne mbledhje u mbajt ky vendim, i cili nenshkruset nga pjesmarresit personalisht, pasi ai u lexua me ze te larte.

**ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM
TE SHOQERISE “MAK - ALBANIA” SH.P.K
Shoqeria “KASTRATI” sh.a**


Perfaqesuar nga ortaku i vetem
Z. Shefqet KASTRATI



MAK ALBANIA Sh.p.k
NUIS: J61821059A